

Shtojca 19



FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik



**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

**Operatori ekonomik "A.M.E 2020" shpk**

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**"A.M.E 2020" shpk**

Nuis/Nipt

**K83725201G**

Adresa

**Durres Bubq BUDULL**

Shteti **Shqiperi**

N/A

**Ura e Gjoles, Nr.Pasurie**

Kodi Postar / Posta

**421/6, Zone Kadastrale**

**1299**

Qyteti

**Durres**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

N/A

**355672049220**

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E-mail

**t.mustafaj1416@gmail.com**

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

**Merita Kajmaku**

**ADMINISTRATOR**

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

**2023/06/27**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

**1. Numri i referencës së procedurës/Lotit**

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

**REF-73401-06-22-2023**



## 2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

**Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

## 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**

## 4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

**8 080 000 (tetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**

## 5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).

**Blerje pleh organik, humus, torfe dhe pleh kimik**

## 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

**2023/07/03**

## 7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

N/A



8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**LIGJI NR. 162 DATE 23.12.2020 PER PROKURIMIN PUBLIK**

**VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK**

**Udhezimet e APP-se / UDHËZIM NR. 07 DATË 30.07.2021 “PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE”**

**Praktika e ndjekur nga KPP , Vendim K.P.P. 495/2020**

**Dokumentat Standarte te Tenderit**

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

*Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)*

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

3. Rrethanat dhe faktet

***Përshkruani rrethanat e faktit.***

**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ne daten 23.06.2023 ka publikuar ne SPE proceduren e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar” me numer REF-73401-06-22-2023 me objekt: « Blerje pleh organik,humus,torfe dhe pleh kimik” , fondi limit: 8 080 000 (tetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**



**Operatori ekonomik "A.M.E 2020"** shpk, nje shoqeri e specializuar nder te tjera dhe ne fushen e Prodhim, rritje, ruajtje, tregtim shumice e pakice, import- eksport te farerave, luleve, fidaneve, pemeve te ndryshme frutore, dekorative etj. Prodhim, kultivim, perpunim, magazinim, ruajtje, rritje dhe tregtim shumice e pakice, import- eksport te bimeve, produkteve bimore(materjale mbjelles dhe shumezues bimor) etj. Punim dhe mirembajtje te siperfaqjeve te gjelberta, parqe dhe pyje, mirembajtje dhe zhvillim dekori ne mjedise urbane. Studim dhe zbatim i projekteve ne siperfaqe te gjelberta (parqe, kende lojrash, lulishte, taraca te gjelberuara, kopshte dhe pyje). Arredim i ambjenteve te gjelberuara, mirembajtje dhe pastrim te tyre. Realizimin e sistemit te vaditjes, tregtim i produkteve te mbrojtjes se bimeve, te plehrave kimike, pesticide, plehra organik, agro ushqimore dhe humus dhe tregtim te vazove dekorative plastike dhe qeramike. Tregtim vazo plastike, qeramike,, duke vleresuar kapacitetet e veta prodhuese, ekonomike, teknike, profesionale, dhe nga eksperiencia shume vjecare ne treg, vleresoi se i permbush te gjitha kriteret ligjore dhe kushtet per realizimin e kesaj procedure prokurimi dhe per realizimin e kontrates te publikuar ne SPE sipas standarteve me te larta, ne realizimin e cdo zeri artikulli qe permban Preventivi i publikuar nga autoriteti kontraktor.

Shprehim interesin tone per te marre pjese ne kete procedure prokurimi dhe pasi jemi njohur me DT e publikuar ne SPE nga ana e autoritetit kontraktor, konstatojmë disa pasaktësi ne përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike per mallrat objekt prokurimi te cilat do jua argumentojmë dhe parashtrojmë si me poshtë vijon.

#### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*


*Ne shoqeria "AME 2020" shpk pasi jemi njohur me DT e publikuar ne SPE nga ana e autoritetit kontraktor, konstatojmë disa pasaktësi ne përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike per mallrat objekt prokurimi paraqesim prane Autoritetit Kontraktor dhe njeherazi edhe prane Komisionit te Prokurimit Publik ankesen kunder pasaktësive apo shkeljeve te kryera nga ana e Autoritetit Kontraktor ne përcaktimin e Kriterëve te Kualifikimit dhe Specifikimeve teknike te mallrave objekt prokurimi, te cilat po i argumentojme si me poshte:*

Ne dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si me poshtë:

#### **Shtojca 7:**

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë prodhues ose furnizues/tregtues i autorizuar i torfës profesionale. Për kete duhet te paraqese:**

- a) *Liçencë prodhimi ose kontratë furnizimi me torfë profesionale*
- b) *Çertifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe duhet te permbush karakteristikat e meposhtme:*
  - *Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra) Përzierie e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët,*
  - *Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lënde organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5kg/m3, Karbonat kalciumi (CaCO3)3-3.5 kg/m3.*



Ose

- Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra): Përzierie e ngurtë me ngjyrë kafe të errët.
- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO): 80% ; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5kg/m<sup>3</sup> : Karbonat kalciumu (CaCO<sub>3</sub>) : 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>

Kundershtojme kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pasi ky përcaktim i bere nga ana e AK është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës, eshte ne shkelje te ligjit dhe kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen e lire pasi kërkesa e AK qe nje operator ekonomik te kete detyrimisht përveç Kontratës se furnizimit njëkohësisht edhe Certifikaten e regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike te cilët furnizohen me disa lloje artikujsh(torfë) por regjistrimin e tyre mund ta realizojnë ne rast se shpallen fitues te procedurës se prokurimit, dhe nuk mund te bëjnë regjistrime artikujsh ne Ministri per cdo tender/produkt qe prokurohet, por produkti (torfa) mund te prodhohet nga prodhuesi sipas kërkesave dhe specifikimeve te kërkuara dhe me pas te regjistrohet ne ministri dhe te tregtohet dhe ti furnizohet autoritetit kontraktor. Pra, janë veprime te cilat nuk duhet te kufizohen ne momentin e ofertimit.

Pra, autoriteti kontraktor sipas argumentimit tone, duhet qe te kerkoje si kriter kualifikimi vetëm disponimin e a) **Liçencë prodhimi ose kontratë furnizimi me torfë profesionale. Eshte përgjegjësia dhe garancia e operatorit qe artikullin e kërkuar (torfën) ta furnizojë sipas specifikimeve teknike.**

Autoriteti kontraktor sipas argumentimit tone duhet te modifikojë kete kriter duke u përcaktuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë prodhues ose furnizues/tregtues i autorizuar i torfës profesionale. Për kete duhet te paraqese:

a) **Liçencë prodhimi ose kontratë furnizimi me torfë profesionale**

### OSE

b) **Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe duhet te permbushe karakteristikat e meposhtme:**

- Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra) Përzierie e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët.
- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5kg/m<sup>3</sup>, Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>)3-3.5 kg/m<sup>3</sup>.

Ose

- Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra): Përzierie e ngurtë me ngjyrë kafe të errët.
- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO): 80% ; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5kg/m<sup>3</sup> : Karbonat kalciumu (CaCO<sub>3</sub>) : 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>

Gjithashtu, përcaktimi i parametrave te torfës - Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra) Përzierie e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët.

- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5kg/m<sup>3</sup>, Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>)3-3.5 kg/m<sup>3</sup>.

Ose

- Pamja e jashtme (gjëndja fizike dhe ngjyra): Përzierie e ngurtë me ngjyrë kafe të errët.



- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO): 80% ; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5kg/m<sup>3</sup> : Karbonat kalciumu (CaCO<sub>3</sub>) : 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>

Ky përcaktim i bere nga AK i parametrave/karakteristikave te artikullit, referon ne nje prodhues te caktuar, dhe nuk le mundësinë per ofrimin e disa artikujve te tjerë ekuivalente është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës.

Gjithashtu, përcaktimi i këtij kriteri do të ndikonte në kufizimin e konkurrencës dhe nuk do të stimulonte pjesëmarrjen e biznesit të vogël në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Ne dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si me poshtë:

#### Shtojca 7:

2.3.6 Të ketë në pronësi ose me qera mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:

- Kamioncina, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton, në pronësi ose me qira.
- Kamioncinë, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës nën 1 ton, në pronësi ose me qira.
- Kamion me vinç, 1 (një) copë , me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira.
- Pirun, 1(një) cope, në pronësi ose me qera

Të paisura me dokumentet si më poshtë:

- Çertifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Leje qarkullimi
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në rregjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin si leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga Operatori Ekonomik me anë të formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Kundershtojme kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pasi ky përcaktim i bere nga ana e AK eshte ne shkelje te ligjit dhe kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen e lire pasi kërkesa e AK nuk justifikon numrin, kapacitetin dhe mënyrën e disponimit te tyre. Gjithashtu referuar zërave te preventivit dhe sasive, nuk eshte e justifikueshme disponimi i 4 kamioncinave por mjafton



disponimi i vetëm 2 kamioncinave me tonazh deri në 1 ton, pasi ky kriter është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës.

Duhet të saktësohet përcaktimi për dokumentat e pronësisë së mjetit pasi, dokumenti Çerifikatë pronësie për mjetet që regjistrohen në DPSHTRR – Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor Tiranë është zëvendësuar nga dokumenti i Lejes së Qarkullimit, e për këtë arsye nuk është e nevojshme të kërkohej ky dokument shtesë pasi është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës. Përcaktimi i këtij kriteri do të ndikonte në kufizimin e konkurrencës dhe nuk do të stimulonte pjesëmarrjen e biznesit të vogël në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Kërkesa e vendosur nga AK për disponimin e një Kamion me vinç, 1 (një) copë, me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira, gjithashtu dhe kërkesa për disponimin e një Piruni përben një kërkesë të dyzuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe si e tillë duhet që të hiqet.

Numri i kamioncinave të përcaktuara në dokumentat e tenderit është diskriminues dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, rëndësinë dhe fondin limit, ndaj si rrjedhim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter duke ulur numrin e mjetit kamioncina të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë:

#### Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### - Torfë importi (substrat me mikroelement ushqyes, paketim 70 litër

1. Të jetë ambalazhuar dhe shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.
2. Të ketë të shkruar mbi ambalazh emërtimin, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.
4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.
5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së torfës i paraqesim më poshtë:

1. Produkti: **Substrati ProfiMix 2b**,
2. Struktura: 60% 0-20% e bardhë A torfë

40 % 0-10 e zezë C torfë

3. Përmbajtja e lagështisë: 40-60%
4. Acideti PH (CaCl): 5,5-6,5
5. Përmbajtje NPK: 14
6. Komponentët plotësues: *Argjilë Radigen*
7. Agjentët e lagështirës: *Flba Zorb*
8. Ambalazhuar në thasë me peshën: 70 litra



- **Torfë (e thjeshtë)**
  1. Përmbajtja e lagështisë: 40 %
  2. Të jetë i pastër nga mbeturinat.
  3. Të jetë e frezuar dhe e sigur.
  4. Të jetë e ambalazhuar në thasë 50 kg.

- **Plehra kimike**

1. Të jenë të ambalazuara dhe të shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.
2. Të kenë të shkruar mbi ambalazh emërtimin e plehut kimik, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e plehut kimik të ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.
3. Plehurat kimike të jenë të ambalazuara sipas llojit dhe përbërjes e gjendjes;
  - për plehurat kimike në gjendje kokrrizore, të jetë në ambalazhe plastike ose letër kundra ujit
  - për plehurat kimike në gjendje pluhur, të jenë në ambalazh letëre kundra ujit
4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.
5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së pesticideve i paraqesim më poshtë:

**Produkti: Nitrofoska**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O	MgO	SO <sub>3</sub>	B	Zn*	Mn*	Fe	Cu*	Mo
Nitrofoska <sup>®</sup> special	12	12	17	2	20	0,02	0,01	-	-	-	-

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr	Emri Shqip	Njësia	Sasia
----	------------	--------	-------





A	. Blerje Pleh organik+humus		
1	Torf importi (70 lit)	litër	120 000
2	Torfë	Kg	80 000
3	Pleh organic	Kg	90 000
4	Humus	Kg	150 000
5	Plehra kimik kristalor	Kv	10
6	NPK	Kv	24
7	Dap	Kv	25
8	Nitrat	Kv	25

**Afatet e lëvrimet: 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e kontratës**

Kundershtojme përcaktimet e autoritetit kontraktor lidhur me specifikimet teknike pasi, autoriteti kontraktor ka vendosur emër MARKE te individualizuar shprehimisht per artikujt qe kërkon te furnizohet, ne kundërshtim haptazi kjo me LPP dhe VKM 285/2021.

Ne procesverbalin e argumentimit te kriterëve, vete autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

Autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike ka përcaktuar artikullin **Produkti: Substrati ProfiMix 2b**, i cili eshte nje marke ekzistuese e nje prodhuesi te caktuar. Me



**kete përcaktim te markës dhe te karakteristikave përkatëse ne shtojcën 5, autoriteti kontraktor i ka vene emrin dhe ka paracaktuar fituesin.**

Pse autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar termin ekuivalente te këtij produkti??? Gjithashtu pse autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar karakteristika produkti variable me marzhe vlerash te ndryshueshme , por i ka vene ato sipas skedës teknike te prodhuesit te individualizuar?

Gjithashtu , autoriteti kontraktor ka përcaktuar ne specifikime teknike edhe artikullin plehra kimike **Nitrofoska®**, me marke te përcaktuar individualisht, pa e justifikuar dhe pa përdorur termin ekuivalente.

Lidhur me pretendimet tona persa i përket specifikimeve teknike, kërkojmë nga AK qe te heqë emërtimin tregtar/markën e prodhuesit **Substrati ProfiMix 2b, dhe Nitrofoska®**, te percaktoje artikujt ekuivalente. Lidhur me karakteristikat e këtyre artikujve duhet ti percaktoje me marzhe ekuivalentimi e jo te përcaktuara me vlera te ngurtësuar sipas nje skede teknike specifike te cilat te orientojnë drejt nje prodhuesi te caktuar.

Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin/shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret kufizuese, përjashtuese, të paqarta ose konfuze, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar

Te nderuar anetare te KPP!

Autoriteti kontraktor ka cenuar rendet parimet e sanksionuara ne ligjin per Prokurimin Publik te cilat jane:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve; b) transparence në procedurat e prokurimit; c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.

*Si perfundim,*

*Referuar parashtrimeve te mesiperme nga shoqeria "A.M.E 2020" shpk, perfundimisht kerkojme nga ana e autoritetit kontraktor dhe nga ana e Komisionit te Prokurimit Publik te marre ne konsiderate dhe te pranoje ankesen e Operatorit Ekonomik "A.M.E 2020" shpk NIPT K83725201G si te bazuar ne fakte dhe ne bazen ligjore ne fuqi dhe te marre masat per rregullimin e shkeljeve duke vendosur:*

1. Pranimin e ankesës.

2. Modifikimin e kriterëve sipas argumentimeve të mësipërme.



**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik.***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail: t.mustafaj1416@gmail.com cel: 0672049220**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit "A.M.E 2020" shpk**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

**Merita Kajmaku**  
**ADMINISTRATOR**

